

LIGJ
Nr. 93/2014

PËR PËRFSHIRJEN DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;

b) përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;

c) përcaktimet për mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nevojave për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si do të sigurohet kjo mbështetje.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
2. “Ndihmësi personal” është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

3. “Pengesat” nënkupton:

a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;

b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar;

c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;

ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

4. "Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

5. "Mjetet ndihmëse" është një pajisje ose një sistem produktesh që mund të modifikohet ose të përshtatet dhe të përdoret për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.

6. "Mohim i përshtatjes së arsyeshme" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

7. "Organizatë e personave me aftësi të kufizuara" është çdo organizatë jofitimprurëse, ku personat me aftësi të kufizuara ose prindërit e tyre kanë shumicën e cilësuar në vendimmarrje.

8. "Organizatë për personat me aftësi të kufizuara" është çdo organizatë jofitimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitet në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.

9. "Persona me aftësi të kufizuara" janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

10. "Përfshirje" është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

11. "Përshtatje e arsyeshme" është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 4 Parimet

Parimet bazë të këtij ligji janë:

a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;

c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;

ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;

d) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;

dh) pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;

e) qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;

ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

KREU II JETESA E PAVARUR

Neni 5

Jetesa e pavarur

1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:

- a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë;
- b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë;
- c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit;
- ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;
- d) në shërbime shoqërore;
- dh) në qendra aftësimi dhe rehabilitimi;
- e) në shërbime shëndetësore përmes infrastrukturës së përshtatshme;
- ë) në transport;
- f) në komunikim dhe informacion;
- g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;
- gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrjeje.

Neni 6

Shërbimet për një jetesë të pavarur

1. Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen: asistencë personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesue-shmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendim-marrja e mbështetur.

2. Shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur kanë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

- a) fokusohen në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale;
- b) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimin dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;

c) krijohen në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit;

ç) janë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit;

d) kanë procedurë të qarta dhe transparente ofrimi;

dh) përfshijnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime;

e) japin mundësinë për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime;

ë) synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Vendimmarrja e mbështetur

1. “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundur kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

2. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ndihmësi personal

1. Ndihmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar.

2. Personat me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme, përfitojnë formim për të mësuar se si t'i udhëzojnë ndihmësit personalë.

3. Mënyrat e përfitimit të formimit të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen në një udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar.

4. Mënyra e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Mjetet ndihmëse

1. Mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisioni, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.

2. Sigurimi i mjeteve ndihmëse rregullohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shën-detësor dhe koordinohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

KREU III

VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE NEVOJAVE PËR NDIHMË E MBËSHTETJE

Neni 10

Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje

1. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.

2. Komisionet multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

3. Komisionet janë të pavarura në vlerësimin dhe në punën e tyre. Ky vlerësim bëhet bazuar në Klasi-fikimin Ndërkombëtar për Funkcionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetit.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet strukturave të saj, kryen:

a) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe procedurave të veprimtarisë së komisionit;

b) bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë për të realizuar trajnimin e anëtarëve të komisioneve e të personelit mbështetës për metodat bashkëkohore të vlerësimit dhe për mjetet mbështetëse që disponohen.

5. Ngritja, administrimi, procedurat e vlerësimit, organizimi e funksionimi i komisionit dhe ankimet e vendimeve rregullohen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

KREU IV

FINANCIMI I AKSESUESHMËRISË

Neni 11

Financimi i aksesueshmërisë

1. Nevojat për asistencë dhe mbështetje, në kuptim të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, mbështeten nga Buxheti i Shtetit. Planifikimi i fondeve të nevojshme për këtë qëllim është kompetencë e ministrisë përgjegjëse në koordinim me ministrinë e linjës për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe bazohet në udhëzime të marra nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike.

3. Masat për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

INSTITUCIONET

Neni 12

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

1. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e kufizuar është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit.

2. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Ata emërohen nga Kryeministri me propozim të gjithë organizatave dhe lirohen me urdhër të Kryeministrit. Përzgjedhja e tyre bëhet duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe

gjinisë.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

4. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik i aftësisë së kufizuar pranë ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar.

5. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Detyrat e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar ka këto detyra:

a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

c) vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;

d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikuara të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;

dh) shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e komisioneve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;

e) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

ë) jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

Neni 14

Bashkëndimi i veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara

1. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre.

2. Nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 15

Organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar

1. Subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë:

- a) individit me aftësi të kufizuara;
- b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara;
- c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara;
- ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në kuptim të nenit 13 të këtij ligji.

2. Çdo organizatë jofitimprurëse, që pretendon se i është mohuar e drejta për t'u konsultuar apo se është përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, ka të drejtë të ankohet, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 16

Monitorimi

1. Avokati i Popullit, monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8328, datë 30.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar.

2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

KREU VI

MBËSHTETJA PËR ZBATIM

Neni 17

Të dhënat dhe statistikat

1. INSTAT-i dhe strukturat përgjegjëse mbledhin të dhëna të përshtatshme statistikore dhe kërkimore, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, për të mundësuar politika dhe planifikime të aksesueshme dhe përfshirëse.

2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë. Llojshmëria e periodesiciteti i mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Imazhi publik dhe ndërgjegjësimi

1. Qeveria nxit një model bashkëkohor të aftësive të kufizuara dhe të dëmtimit, duke rritur ndërgjegjësimin për barazinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke theksuar mjetet për mbështetje dhe ndihmë për të siguruar mundësi dhe kushte të barabarta me të tjerët.

2. Media publike dhe private nxit përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet imazheve që theksojnë mosdiskriminimin, autonominë e personave me aftësi të kufizuara dhe sigurojnë mundësitë që këta persona të flasin vetë për veten e tyre.

3. Qeveria rrit ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në shoqëri me fushata ndërgjegjësuëse.

Neni 19

Formatet e aksesueshme

Ky ligj, ligje të tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të personave me aftësi të kufizuara është i disponueshëm në format të aksesueshëm, i cili është printimi dhe botimi i teksteve në Braille, printim me shkronjë të madhe, në gjuhë të thjeshtuar, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Ndryshimet në legjislacion

Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuara, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.

Neni 21

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 3, dhe 17, pika 2, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, dhe 11, pika 3, brenda 6 muajve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3, 7, pika 3, 10, pika 5, dhe 20, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.
2. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuara të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të pikës 3, të nenit 8, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.7.2014

KRYETARI
Ilir Meta